



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 15

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8875 datë 4.4.2002	Për Rojën Bregdetare shqiptare	435
Ligj nr. 8876 datë 4.4.2002	Për shëndetin riprodhues	438
Ligj nr. 8877 datë 4.4.2002	Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes të Investimeve të Huaja.....	446
Ligj nr. 8878 datë 15.4.2002	Për ratifikimin e “Protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar (Tika) të Republikës së Turqisë”.....	448
Ligj nr. 8879 datë 15.4.2002	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Bashkëpunimit Teknik e Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”	451

		
Ligj nr. 8880 datë 15.4.2002	Për të drejtat e seleksionerit të bimëve	454
Vendim i KM nr. 170, datë 25.4.2002	Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre	466
Vendim i KM nr. 190, datë 9.5.2002	Për publikimin për herë të dytë të disa objekteve dhe pjesëve të kapitalit shtetëror në shoqëritë me kapital të përbashkët, për të cilat kanë filluar procedurat e privatizimit	469

L I G J
Nr.8875, datë 4.4.2002

PËR ROJËN BREGDETARE SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të kapitullit 3 pika 42 paragrafi i parë të Dokumentit për Politikën e Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Krijimi i Rojës Bregdetare për zbatimin e ligjshmërisë në det.

Neni 2
Përkufizime

Me termat:

a) “Rojë Bregdetare” kuptohet struktura, sistemi i vrojtimit të hapësirës detare, personeli, mjetet (anije dhe helikopterë), në përbërje dhe në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

b) “Ujëra të brendshme” kuptohet brezi ujqor që përfshihet midis vijës bazë dhe vijës bregdetare.

c) “Vijë bazë” kuptohet tërësia e vijave të drejta që bashkojnë kepet dhe pikat më të dala të bregdetit shqiptar.

ç) “Deti territorial” kuptohet brezi ujqor që përfshihet midis vijës bazë dhe vijës së hequr paralel me të nga ana e detit, në distancën 12 milje vijë detare.

d) “Zonë fqinje” kuptohet brezi ujqor në vazhdim të detit territorial. Zona fqinje shtrihet deri në 24 milje detare nga vija bazë në drejtim të detit të hapur.

dh) “Zonë ekonomike ekskluzive” kuptohet hapësira ujqore në vazhdim të detit territorial deri në vijën e mesme, çdo pikë e së cilës është e baraslanguar nga pikat më të afërta të vijave bazë, përkatësisht të bregdetit shqiptar dhe atij italian.

e) “Ndjekje e nxehtë” kuptohet vazhdimi i operacionit të ndjekjes së mjeteve detare që shkelin ligjshmërinë në det dhe në mënyrë të hapur nuk i binden autoritetit të Rojës Bregdetare, si dhe tentojnë të kalojnë në ujërat territoriale të shteteve fqinje.

ë) “Manuali i Rojës Bregdetare” është akti nënligjor në të cilin përcaktohen rregullat bazë dhe procedurat që zbatohen nga Rojat Bregdetare për ushtrimin e ligjshmërisë në det.

Neni 3
Varësia e Rojës Bregdetare

1. Roja Bregdetare varet nga Ministria e Mbrojtjes dhe është pjesë e distrikteve detare, të cilat varen nga Komanda e Forcave Detare.

2. Roja Bregdetare bashkëvepron me institucione dhe subjekte shtetërore ose private me interesa në det.

3. Mënyra e komunikimit të Rojës Bregdetare me këto institucione dhe subjekte shtetërore përcaktohet me marrëveshje të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare.

Neni 4

Struktura organizative dhe mjetet e Rojës Bregdetare

1. Struktura organizative e Rojës Bregdetare miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.
2. Mjetet, sasia e tyre, personeli, sistemet e vrojtimit dhe të komunikimit, sallat operative përcaktohen në strukturën organizative të Rojës Bregdetare, si pjesë e strukturës së Forcave Detare.
3. Roja Bregdetare pajiset me mjetet detare që janë të përcaktuara në strukturën organizative të Forcave Detare dhe me mjete ajrore (avionë dhe helikopterë).
4. Mjetet janë anije, avionë dhe helikopterë ushtarakë. Shenjat dalluese të anijeve dhe avionëve të Rojës Bregdetare janë mbishkrimet “Roja Bregdetare” dhe “Coast Guard”, të vendosura në të dy krahët, në pjesën anësore të tyre, së bashku me stemën përkatëse.

Neni 5

Detyrat e Rojës Bregdetare

1. Roja Bregdetare ka për detyrë:
 - a) të zbatojë legjislacionin shqiptar dhe aktet e normat e së drejtës ndërkombëtare, të pranuar nga Republika e Shqipërisë, në hapësirën detare shqiptare;
 - b) të japë asistencë për sigurimin e lundrimit detar dhe sigurimin e jetës në det (SAR), në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë bën pjesë, i ka ratifikuar ose ka aderuar në to;
 - c) të parandalojë dhe të ushtrojë kontroll për kalimin e paligjshëm të mjeteve lundruese, të mallrave dhe njerëzve në hapësirën detare shqiptare;
 - ç) të kryejë afrim, bordim, inspektim, ndalim, kapje dhe bllokim të mjeteve dhe personave që shkelin legjislacionin detar, si dhe shoqërimin e tyre në portin më të afërt, sipas rastit;
 - d) të kryejë ndjekjen e nxehtë të mjeteve detare, sipas konventave ndërkombëtare;
 - dh) të kryejë përdorimin e forcës në rastet e mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme;
 - e) të kryejë përpilimin e dokumentacionit bazë për fillimin e procedurave të mëtejshme për shkelësit e ligjit detar;
 - ë) të parandalojë dhe të ushtrojë kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndotjen e mjedisit detar dhe bregdetar (MARPOL);
 - f) të ushtrojë kontroll në zbatimin e legjislacionit për peshkimin detar;
 - g) të ushtrojë kontroll në zbatimin e legjislacionit për lundrimin turistik;
 - gj) të ushtrojë kontroll në zbatimin e legjislacionit për ruajtjen e pasurive detare, nëndetare dhe të fundit të detit;
 - h) të ushtrojë kontroll në zbatimin e legjislacionit për ruajtjen e vlerave arkeologjike dhe kulturore në hapësirën detare shqiptare.
2. Roja Bregdetare i ushtron detyrat e mësipërme në detin territorial, në zonën fqinje, dhe në zonën ekonomike ekskluzive.

Në ujërat e brendshme Roja Bregdetare ofron ndihmë dhe bashkëpunon me Policinë Kufitare, me kapiteneritë e porteve e me institucione të tjera shtetërore.
3. Procedurat për kryerjen e detyrave nga Roja Bregdetare përcaktohen në Manualin e Rojës Bregdetare.
4. Për kryerjen e detyrave të lartpërmendura, oficerët e Rojës Bregdetare gëzojnë statusin e Policisë Gjyqësore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 6

Kundërvajtjet administrative

1. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të përcaktuara në Manualin e Rojës Bregdetare zbatohen masat e parashikuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, me ndryshimet përkatëse.
2. Autoriteti i Rojës Bregdetare ushtron të drejtën e dhënies së masës për kundërvajtjet administrative, në përputhje me ligjet që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve me përgjegjësi dhe interesa në det.

Neni 7

Fusha e veprimit dhe e bashkëpunimit

1. Në detin territorial, në zonën fqinje dhe në zonën ekonomike ekskluzive kompetencat e Rojës Bregdetare janë parësore për realizimin e detyrave të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, si dhe të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është Palë.

2. Në hapësirën detare shqiptare, Roja Bregdetare u ofron ndihmë dhe bashkëpunim subjekteve juridike e fizike, vendase dhe të huaja, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e normat e së drejtës ndërkombëtare për detin, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Neni 8

Burimet financiare

1. Burimet financiare për pajisjen me mjete, stërvitjen e personelit dhe funksionimin e Rojës Bregdetare përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes si zë i veçantë.

2. Në rastet kur në mjetet detare dhe ajrore të Rojës Bregdetare kërkohet instalimi i impianteve, mekanizmave, aparaturave, pajisjeve ose teknologjisë së veçantë, në interes të realizimit të detyrave specifike të ministrive, institucioneve të ndryshme, si dhe shërbimet e tjera në interes të tyre, mbështetja financiare për këtë qëllim bëhet nga institucionet shtetërore ose private të interesuara ose nga Buxheti i Shtetit.

Neni 9

Masat administrative

Gjobat, sekuestrimet në sende, në mallra, në vlera financiare dhe në mjete lundrimi vendosen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton Manualin e Rojës Bregdetare brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ministrinë dhe institucionet përkatëse që kanë interesa në det, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e miratimit të këtij ligji, përgatisin marrëveshjet përkatëse për përcaktimin e rregullave bazë të bashkëveprimit ndërmjet tyre për zbatimin e ligjshmërisë në det.

Neni 11

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.3299, datë 19.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8876, datë 4.4.2002

PËR SHËNDETIN RIPODHUES

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore private dhe publike, mbron të drejtat riprodhuese të individit e të çiftit dhe siguron që të drejtat riprodhuese të çdo individit të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare e me principe të tjera të njohura ndërkombëtare.

Neni 2

"Shëndeti riprodhues" nënkupton mirëqenien e përgjithshme fizike, mendore, në tërësi, me mungesën e sëmundjeve e paaftësive problematike, si dhe çdo kushtëzim tjetër bazë që i nevojitet sistemit të riprodhimit për funksionet, proceset si dhe aftësinë e një jete seksuale të kënaqshme e të sigurt. Ai nënkupton aftësinë e njerëzve për t'u riprodhuar dhe lirinë e tyre për të vendosur për mënyrën dhe kohën e riprodhimit, si dhe të informohen se ku mund ta bëjnë këtë dhe ku mund të gjejnë të tilla shërbime.

Neni 3

Kujdesi për shëndetin riprodhues përfshin një tërësi metodash, teknikash dhe shërbimesh shëndetësore që ndikojnë mbi shëndetin riprodhues të njerëzve, duke parandaluar dhe zgjidhur problemet e tyre, si më poshtë:

- a) shërbime dhe këshillim, informim, edukim, komunikim për planifikimin familjar;
- b) shërbime dhe edukim për kujdesin para lindjes, lindjen e sigurt dhe kujdesin pas lindjes, veçanërisht ushqyerjen me gji;
- c) shërbime dhe edukim për fëmijët, adoleshentët dhe kujdes shëndetësor për gruan;
- ç) parandalimin dhe trajtimin për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS, e infeksioneve dhe sëmundjeve të traktit riprodhues;
- d) abortin e sigurt dhe menaxhimin e komplikacioneve lidhur me abortin;
- dh) informim, edukim dhe këshillim mbi seksualitetin dhe shëndetin riprodhues;
- e) shërbime referimi për planifikimin familjar, komplikacionet e shtatzanisë, abortin, infertilitetin, infeksionet e traktit riprodhues, kanceret e gjirit dhe kanceret e sistemit riprodhues, menopauzën, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS;
- ë) parandalimin dhe trajtimin e përshtatshëm të infertilitetit.

Neni 4

1. Shëndeti seksual është pjesë e shëndetit riprodhues dhe nënkupton përmirësimin e jetës dhe marrëdhënieve seksuale të shëndetshme, informimin, këshillimin, kujdesin lidhur me riprodhimin dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

2. Shëndeti seksual përfshin:

- a) zhvillimin normal;
- b) marrëdhëniet seksuale të barabarta dhe të përgjegjshme të pranura njëloj nga secili partner;
- c) mënjanimin e sëmundjeve dhe çdo paafësie, detyrimit, dhunës dhe çdo sjelljeje e praktike të dëmshme të lidhura me seksualitetin;
- ç) realizimin e një jete optimale seksuale.

Neni 5

Të gjithë individët kanë të drejtë të informohen, të këshillohen, të marrin edukimin dhe shërbimin e nevojshëm shëndetësor dhe social për të pasur një shëndet të mirë seksual, si dhe të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre riprodhuese dhe seksuale.

Neni 6

1. Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t'u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues.

2. Respektimi reciprok i marrëdhënieve të barabarta nga ana e grave dhe burrave gjatë lidhjeve seksuale dhe riprodhimit nënkupton respektin, moscenimin e integritetit të secilit, mirëkuptimin dhe ndarjen e përgjegjësiave për sjelljet seksuale dhe pasojat e tyre.

Neni 7

Mëmësia e sigurt kupton të drejtën që çdo grua të marrë kujdesin që i nevojitet për të pasur një shëndet të mirë nga shtatëzania deri në lindjen e fëmijës. Elementet kryesore për të siguruar mëmësinë e sigurt përfshijnë aksesin për kujdes me cilësi të lartë para lindjes, gjatë dhe pas lindjes, parandalimin e shtatzanive të padëshiruara, parandalimin e abortit të pasigurt dhe të lindjes së parakohshme.

KREU II TË DREJTAT RIPODHUESE

Neni 8

1. Të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtën të vendosin lirisht, por duke respektuar dëshirën e secilit partner, për kohën, numrin e intervalin e lindjeve, të informohen për mjetet e duhura të realizimit të tyre, të kërkojnë standardet më të larta të shëndetit riprodhues dhe atij seksual.

2. Ky ligj i garanton çdo individ vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna.

Neni 9

Çdo individ ka të drejtën të zgjedhë marrëdhëniet e tij seksuale dhe të kontrollojë jetën e tij riprodhuese. Zgjedhja duhet të bëhet me vullnetin e tij që nënkupton:

- a) asnjë grua nuk duhet të detyrohet të jetë shtatzënë;
- b) çdo ndërhyrje mjekësore e lidhur me shëndetin riprodhues dhe seksual duhet kryer me pëlqimin (pranimin) e personit mbi të cilin do të kryhet ndërhyrja.

Neni 10

1. Të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtë të përfitojnë nga përdorimi i metodave të sigurta,

të përballueshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar, sipas zgjedhjes së tyre, si dhe ndaj metodave të tjera të zgjedhura për rregullimin e fertilitetit.

2. Të gjithë individët dhe çiftet kanë të drejtë të përfitojnë shërbime të përshtatshme të kujdesit shëndetësor për të pasur shtatzani dhe lindje të sigurt dhe një fëmijë të shëndetshëm.

3. Të gjithë individët kanë të drejtë për të përfituar nga progresi shkencor dhe teknologjitë e reja lidhur me riprodhimin e seksualitetin, kur ato janë të sigurta dhe të pranueshme.

Neni 11

1. Gruaja ka të drejtë për një mëmësi të sigurt dhe për mënjanimin e shtatzanisë së padëshiruar, e cila mund të kërcënojë jetën e saj. Jeta e gruas nuk duhet ekspozuar ndaj rrezikut të lidhur me shtatzëninë, lindjen e pengesa të tjera që lidhen me pabarazinë gjinore.

2. Shërbimet e planifikimit familjar duhet të përdoren dhe të promovohen si mjet për shmangien e shtatzënieve të padëshiruara.

3. Çdo grua ka të drejtën për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënisë së saj, për asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave e praktikave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj ose shëndetin e fetusit, të të porsalindurit dhe fëmijës.

Neni 12

1. Çdo individ ka të drejtën për edukim shëndetësor.

2. E drejta për edukim shëndetësor përfshin mundësinë për t'u informuar në mënyrë të përshtatshme dhe edukimin në fushën e të drejtave riprodhuese dhe seksuale. Liria për shëndetin riprodhues e seksual nuk duhet të kufizohet nga influenca e fesë, e filozofisë ose e kulturës dhe ideologjisë.

Neni 13

1. Çdo individ ka të drejtë për kujdes mjekësor dhe shërbime bazë të nevojshme mjekësore, që janë bazë për të mbrojtur shëndetin e mirëqenien e tij si individ dhe gëzon të drejtën për kujdes të kualifikuar për shëndetin riprodhues e seksual.

2. Mëmësia dhe fëmija kanë të drejtën për kujdes shëndetësor dhe mbështetje të veçantë.

3. Çdo individ në moshën e riprodhimit mund të kërkojë ekzaminime mjekësore dhe trajtim të përshtatshëm e rehabilitim për riprodhim të shëndetshëm.

Neni 14

1. Kujdesi dhe shërbimet shëndetësore për shëndetin riprodhues ofrohen nga shërbimet mjekësore shtetërore, nga persona juridikë publikë dhe privatë, si dhe nga personat që kanë të drejtë të ushtrojnë këtë veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi, që janë të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë për këtë lloj veprimtarie.

2. Shërbimet mjekësore shtetërore, personat juridikë publikë dhe privatë, si dhe personat që kanë të drejtë të ushtrojnë këtë veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe anonimitetin e të dhënave, për të cilat vihen në dijeni për shkak të veprimtarisë që ato ushtrojnë.

Neni 15

1. Me sterilizim kuptohet një procedurë mjekësore kirurgjikale, me anë të së cilës kryhet ndalimi i përhershëm i aftësisë për riprodhim të një individi.

2. Sterilizimi është një metodë e ligjshme për planifikimin familjar dhe kryhet vetëm kur:

a) pacienti jep pëlqimin me shkrim;

individ plotëson kriterin moshë.

Neni 16

Çdo individ ka të drejtën, në përputhje me dëshirat e veta, t'u nënshtrohet metodave kirurgjikale për sterilizimin.

Neni 17

Çdo individ ka të drejtën të mbrojë aftësitë e tij riprodhuese, duke u ankuar kundër veprimeve, vendimeve, dëmeve të të tretëve, kur cenohen të drejtat që lidhen me shëndetin riprodhues.

Neni 18

Çdo individ duhet t'i sigurohet informim dhe shërbime shëndetësore, t'i jepet ndihmë mjekësore dhe sociale me metodat e teknikat e zgjedhura, në përputhje me veçoritë individuale të pranuar dhe të parashikuara me ligj, për të parandaluar shtatzëninë e padëshiruar, duke pasur parasysh gjendjen e shëndetit, moshën dhe karakteristikat individuale.

Neni 19

Adoleshentët, të rinjtë gëzojnë të drejtën për informim dhe shërbime për shëndetin riprodhues, për informim dhe programe që synojnë parandalimin e shtatzënive të padëshiruara, abuzimeve dhe për gjithçka që lidhet me sjelljen e tyre aktive seksuale, në përputhje me moshën e tyre.

Neni 20

1. Të gjithë individët kanë të drejtën për:
 - a) trajtimin e infertilitetit, përfshirë zbatimin e metodave dhe teknologjive moderne për riprodhimin;
 - b) informacion për përmbajtjen e teknologjive riprodhuese suplementare, efencën, periudhat optimale për zbatimin e tyre, pasojat mjekësore dhe pasojat e mundshme, si dhe informimin mbi vlefshmërinë e metodave të tjera për trajtimin e infertilitetit.
2. Çiftet dhe individët do të kenë të drejtën për zbatimin e teknologjive riprodhuese vetëm në rast të një marrëveshjeje të përbashkët.

KREU III ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË SHËNDETIT RIPODHUES

Neni 21

Ministri i Shëndetësisë përcakton strukturat dhe shërbimet e shëndetit riprodhues, kriteret, rregulloret e funksionimit të tyre, si dhe politikën e strategjinë e zhvillimit për shëndetin riprodhues.

Neni 22

- Veprimtaria e shërbimeve për kujdesin ndaj shëndetit riprodhues përfshin:
- a) kujdesin para, gjatë dhe pas lindjes;
 - b) kujdesin për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës 0-6 vjeç;
 - c) kujdesin për shëndetin e adoleshentëve;
 - ç) kontrollin dhe mjekimin e sëmundjeve ngjitëse seksualisht të transmetueshme HIV/AIDS;
 - d) informimin dhe edukimin seksual;
 - dh) parandalimin e shtatzënive të padëshiruara nëpërmjet metodave kontraceptive të planifikimit familjar;
 - e) ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë;
 - ë) kurimin e sterilitetit dhe teknikat e riprodhimit;
 - f) trajtimin e sëmundjeve të traktit riprodhues;

g) trajtimin e menopauzës.

Neni 23

1. Shërbimi i shëndetit riprodhues organizohet në klinika publike dhe private të specializuara dhe të licencuara në të tria nivelet e kujdesit shëndetësor mbi bazën e udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë.

2. Shërbimet e shëndetit riprodhues në kujdesin shëndetësor parësor kryejnë parandalimin, zbulimin, trajtimin e problemeve të shëndetit riprodhues, informimin dhe edukimin shëndetësor, ndjekjen e patologjive në sistemin riprodhues.

Neni 24

1. Të gjitha gratë shtatzëna përfitojnë falas ndjekjen periodike mjekësore të shtatzënisë, të lindjes dhe të paslindjes, veçanërisht ekzaminimet e paralindjes dhe të paslindjes, të detyrueshme, që caktohen me akt të Ministrit të Shëndetësisë.

2. Numri dhe lloji i ekzaminimeve të detyrueshme dhe periudha e kryerjes së tyre përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Të gjitha gratë shtatzëna kanë të drejtë të kryejnë pa pagesë ekzaminimet e detyrueshme të përshkruara nga mjeku dhe të marrin falas fletoren personale të ndjekjes së shtatzënisë.

Neni 25

1. Të gjithë fëmijët 0-6 vjeç përfitojnë masa parandaluese shëndetësore, si dhe kontroll e ndjekje mjekësore falas.

2. Numri i ekzaminimeve dhe kontroleve që duhen kryer për fëmijët 0-6 vjeç, si dhe institucionet që do t'i kryejnë përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 26

Metodat kontraceptive për planifikimin familjar, të pranueshme për t'u përdorur në vend, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Shëndetësisë, ku do të përfshihen kondomet, metodat barrierë vaginale, kontraceptivët oralë, implantet, injektablët, IUD, sterilizimi mashkullor e femëror vullnetar dhe kontracepsioni i emergjencës. Gjithashtu pacientët/klientët duhet të marrin informacion të hollësishëm për rreziqet dhe përparësitë e çdo metode.

KREU IV DIAGNOSTIKIMI PARA LINDJES

Neni 27

Në kuptim të shëndetit riprodhues, diagnostikimi para lindjes është i lejueshëm për të gjitha gratë.

Neni 28

Rregullat, kushtet dhe metodat e veçanta për diagnostikimin para lindjes do të përcaktohen me akte të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 29

Për ekzaminimet që kryhen lidhur me diagnostikimin para lindjes, informacioni duhet të jepet në mënyrë të atillë që grua të ndiejë liri të plotë zgjedhjeje.

KREU V TEKNIKAT E RIPRODHIMIT MJEKËSOR TË ASISTUAR

Neni 30

Riprodhimi mjekësor i asistuar ka për qëllim t'i përgjigjet kërkesës së një individi ose të një çifti për të pasur fëmijë. Ai synon të trajtojë një ose disa shfaqje mjekësore të infertilitetit, që bëjnë që një çift të mos arrijë një shtatzëni me rrugë natyrore.

Neni 31

Riprodhimi mjekësor i asistuar përfshin praktikat klinike dhe biologjike, të cilat mundësojnë konceptimin in vitro, transferimin e embrioneve dhe inseminimin artificial, si dhe të gjitha teknikat e tjera të barasvlershme që lejojnë riprodhimin jashtë procesit natyror.

Neni 32

Zbatimi i teknikave të riprodhimit kryhet:
kur individi ka mbushur moshën për t'u martuar;
b) kur bashkëshortët kanë dështuar në përpjekjet për një periudhë prej dy vjetësh për të pasur fëmijë deri në momentin kur kryhet transferimi i embrionit dhe inseminimi;
c) në prani të mjekut specialist të licencuar;
ç) vetëm pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim për çdo cikël nga individët e interesuar.

Neni 33

Teknikat e riprodhimit përdoren vetëm në rastet kur:
a) metoda të tjera të trajtimit kundër infertilitetit të burrit ose të gruas nuk janë produktive ose të përshtatshme dhe nuk garantojnë rezultatin e dëshiruar;
b) parandalojnë transmetimin të fëmijës së sëmundjeve gjenetike, si dhe të sëmundjeve të tjera që do të rezultojnë në një vdekje të parakohshme, në prapambetje mendore të tij dhe invaliditet të rëndë;
c) konsiderohen si një alternativë për lindje natyrore.

KREU VI INSEMINIMI ARTIFICIAL

Neni 34

Me inseminim artificial kuptohet përfitimi i semeneve nga donatori dhe injektimi i tyre te gruaja. Kjo kryhet kur:
bashkëshorti i saj rezulton infertil;
dhuruesi nuk është bashkëshorti i gruas.

Neni 35

Inseminimi artificial me bashkëshortin kryhet nëpërmjet injektimit të semeneve të bashkëshortit të bashkëshortja. Inseminimi artificial me bashkëshortin përdoret vetëm në rastin kur paaftësia e çiftit për të lindur nuk vjen si rezultat i mungesës së aftësisë riprodhuese të burrit.

Neni 36

Kushtet dhe kërkesat për kryerjen e teknologjive riprodhuese të asistuara, inseminim-fekondim artificial, me pasoja implantin embrional, përcaktohen me akt të Ministrit të Shëndetësisë.

Neni 37

Gjatë përdorimit të teknologjive riprodhuese të asistuara, nuk lejohet zgjedhja e seksit të fëmijës së ardhshëm, me përjashtim të rasteve kur ka mundësi për të trashëguar sëmundje të lidhura me seksin.

Neni 38

Embrioni human ndalohet të përdoret për çfarëdolloj qëllimi tjetër komercial ose industrial dhe eksperimental.

Neni 39

1. Burrat dhe gratë kanë të drejtën për të ruajtur qelizat seksuale.
2. Kushtet dhe kërkesat e ruajtjes dhe vendosjes së qelizave seksuale do të përcaktohen me akt të Ministrit të Shëndetësisë.

KREU VII FEKONDIMI ARTIFICIAL IN VITRO

Neni 40

Me fekondim artificial kuptohet fertilizimi në rrugë eksperimentale i vezëve femërore me spermën e mashkullit, të një çifti jashtë organizmit të gruas. Pjesëmarrja në të kushtëzohet nga pëlqimi me shkrim i gruas, e cila dhuron vezët dhe burrit që dhuron spermën.

Neni 41

Fekondimi artificial zbatohet në një nga rastet kur:

- te gruaja shfaqen dëmtime ose defekte në tuba;
- b) burri është infertil ose bartës i sëmundjeve gjenetike me rrezik për jetën;
- c) sperma e partnerit mashkull rezulton e papërshtatshme për kryerjen e një lindjeje natyrore.

KREU VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 42

1. Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet pararendëse të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen nga Ministri i Shëndetësisë ose nga persona të autorizuar prej tij si vijon:

- a) për ushtrim profesioni në fushën e shëndetit riprodhues nga mjekët e këtij specialiteti pa licencë, me gjobë nga 25 000 deri në 100 000 lekë;
- b) për funksionimin e institucioneve shëndetësore private pa licencë në fushën e shëndetit riprodhues, me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Në rast përsëritjeje të shkeljeve të parashikuara në shkronjat a dhe b të pikës 1 të këtij neni merren masat e mëposhtme:

- sekuestrimi i pajisjeve të institucionit;
- heqja e të drejtës së ushtrimit të profesionit;
- kallëzim penal.

Neni 43

Ministri i Shëndetësisë detyrohet që të nxjerrë akte të veçanta për të përcaktuar specifikimet

lidhur me:

inseminimin artificial;
teknikat e riprodhimit të asistuar;
adoptimin surrogativ.

Neni 44

1. Ministri i Shëndetësisë duhet të sigurojë falas për adoleshentët shërbime të shëndetit riprodhues dhe të edukatës seksuale.

2. Ministri i Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit detyrohen që të nxjerrin akte të veçanta për të përcaktuar specifikimet lidhur me:

a) institucionet arsimore dhe ato shëndetësore për adoleshentët për edukatën seksuale;
b) modelet e programeve të edukimit për edukatën seksuale dhe mbrojtjen e shëndetit riprodhues.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3300, datë 19.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8877, datë 4.4.2002

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË NXITJES TË INVESTIMEVE TË HUAJA

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Objekti i këtij ligji është krijimi i Agjencisë së Nxitjes të Investimeve të Huaja, përcaktimi i fushës së veprimtarisë, si dhe i parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e saj.

2. Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë së Nxitjes të Investimeve të Huaja përcaktohen në statutin e saj. Statuti i Agjencisë miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 2

Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja, që më poshtë do të quhet “Agjencia”, është person juridik publik. Emërtimi i shkurtuar i Agjencisë është ANIH.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë së Agjencisë është:

a) nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja, në përputhje me projektet parësore të

investimit në Republikën e Shqipërisë;

b) identifikimi i mundësive për investime në Shqipëri dhe promovimi i tyre;

c) bashkëpunimi me institucione publike, financiare, organizata të biznesit dhe të investitorëve, me qëllim hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare për nxitjen e investimeve të huaja;

ç) propozimi i politikave dhe mbështetja e programeve dhe projekteve në nivel kombëtar, rajonal dhe sektorial lidhur me përmirësimin e klimës dhe thithjen e investimeve të huaja;

d) zhvillimi i veprimtarive të promocionit, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë;

dh) dhënia e asistencës për lehtësimin e investimeve të huaja dhe sigurimi i shërbimeve mbështetëse për investitorët;

e) publikimi i informacionit zyrtar për investimet në Shqipëri.

Neni 4

Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të bashkëpunojnë me agjencinë, të shkëmbejnë informacione dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve dhe funksionet e veprimtarisë së Agjencisë.

Neni 5

1. Agjencia, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të realizojë të ardhura nëpërmjet shërbimeve që kryen, në funksion të qëllimit dhe fushës së veprimtarisë së saj.

2. Nuk lejohet që Agjencia të ushtrojë veprimtari fitimprurëse.

3. Agjencia përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve me mjetet e veta.

ORGANET DREJTUESE TË AGJENCISË

Neni 6

1. Organet drejtuese të Agjencisë janë:

Këshilli Mbikëqyrës;

Drejtori Ekzekutiv.

2. Këshilli Mbikëqyrës ka në kompetencë të përcaktojë strategjinë, fushat dhe programin e veprimtarive të Agjencisë, të shqyrtojë dhe të miratojë aktet më të rëndësishme në lidhje me administrimin, organizimin, çështjet financiare dhe buxhetin e saj, mbikëqyrjen dhe kontrollin në vazhdimësi të realizimit të tyre, si dhe vendos për çështje të tjera të parashikuara në ligj ose në statutin e Agjencisë. Këshilli Mbikëqyrës miraton strukturën organizative të Agjencisë dhe emëron e liron Drejtorin Ekzekutiv. Procedurat e emërimit dhe të lirimit nga detyra të Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen në statutin e Agjencisë.

3. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë, si dhe mënyra e masa e shpërbllimit të anëtarëve të tij, caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

Drejtimi i veprimtarisë së përditshme dhe përfaqësimi i Agjencisë në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit të Agjencisë, bëhet nga Drejtori Ekzekutiv i saj.

FINANCAT E AGJENCISË

Neni 8

1. Burimet e financimit të veprimtarisë së Agjencisë janë:

- Buxheti i Shtetit;
donatorë të ndryshëm;
të ardhura nga shërbimet dhe projektet e realizuara nga Agjencia.
2. Veprimtaria e Agjencisë financohet nga Buxheti i Shtetit në përputhje me situatën financiare.
3. Llogaritë e Agjencisë kontrollohen nga ekspertë kontabël të autorizuar.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 1, 6, dhe 8 të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3301, datë 19.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J

Nr.8878, datë 15.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E “PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE USHQIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË TURKE TË KOOPERIMIT NDËRKOMBËTAR (TIKA) TË REPUBLIKËS SË TURQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Protokolli i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar (TIKA) të Republikës së Turqisë për mbarështimin e lopës së racës “Xhersej” dhe për nxitjen e krijimit të shoqatave të fermerëve të mbarështimit të gjedhit “Xhersej” në rajonin e Malësisë së Madhe dhe Shkodrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3309, datë 25.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PROTOKOLL

BASHKËPUNIMI MIDIS MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE USHQIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË TURKE TË KOOPERIMIT NDËRKOMBËTAR (TIKA) TË

REPUBLIKËS TURKE

Mbi mbarështimin e lopës së racës xhersej dhe nxitjen e krijimit të shoqatës së fermerëve të gjedhit xhersi në rajonin e malësisë së madhe dhe Shkodrës

Neni 1

Palët

Palët e këtij Protokolli janë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shqipërisë dhe Kryeministria Turke, Agjencia Turke e Kooperimit Ndërkombëtar (e quajtur TIKA).

Neni 2

Subjekti dhe objektivat

TIKA dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shqipërisë do të bashkëpunojnë në realizimin e Projektit të përgatitur për ngritjen e sistemit të mbarështimit të gjedhit në përshtatje me kushtet e vendit në rajonin e Malësisë së Madhe dhe Shkodrës dhe do të organizojë fermerët e gjedhit në shoqata fermerësh.

Projekti do kërkojë përdorimin e plotë të potencialit gjenetik të tufës së gjedhit, shtimin e fitimeve në sektorin e mbarështimit të gjedhit dhe organizimin e rritësve në shoqata.

Neni 3

Detyrimet e TIKA-s

a) TIKA do emërojë një konsulent projekti për një periudhë, së paku 2 muaj në vit për kryerjen e detyrave të përcaktuara në Projekt.

b) TIKA do të mundësojë përgatitjen e një programi trainimi për 3 grupe rritësish me nga 10 persona për një periudhë 5-ditore për mbarështimin e kafshëve, të ushqyerit e kafshëve, organizimin e shoqatave të fermerëve të gjedhit, sëmudjet e kafshëve dhe inseminimin artificial.

c) TIKA do të ngrejë programin kompjuterik të mbarështimit dhe do të emërojë një ekspert për Shqipërinë dhe koordinimin e versioneve të tyre vjetore për një periudhë të shkurtër.

d) TIKA do të sigurojë një përkthyes për konsulentin e Projektit.

e) TIKA do të sigurojë mjetet, material për inseminimin artificial, detektorin e proteinës në qumësht (nëse është e nevojshme), material për matrikullimin e kafshëve, kovë për matjen e qumështit dhe kompjuter dhe program mbarështimi.

Neni 4

Detyrimet e Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë dhe Ushqimit

Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të emërojë një koordinator kombëtar shqiptar të Projektit për të punuar me konsulentin turk të Projektit ose vetëm dhe të autorizuar të drejtojë ekipin shqiptar të Projektit me përpikmëri, të monitorojë dhe të vlerësojë veprimtaritë.

b) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të mundësojë punësimin e personelit shqiptar të përcaktuar në pjesën e dokumentit të projektit për kontributin shqiptar të projektit (p.sh. shoferët, përkthyesit, sekretarë, ekspertë etj.) gjatë gjithë periudhës së Projektit.

c) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të sigurojë zyrat dhe ambientet në Tiranë dhe në rajonin ku projekti do të aplikohet.

d) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përballojë koston e përkthimit dhe interpretimit dhe shpenzimet e komunikimit, si telefon, faks dhe internet.

e) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të mundësojë instalimin e sistemit kompjuterik, duke krijuar kushtet e nevojshme teknike dhe ligjore.

f) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përballojë mirëmbajtjen e automjetit, riparimin dhe shpenzimet e karburantit.

g) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të inkurajojë ngritjen e një shoqate të veçantë rritësish që do të adaptojnë Projektin dhe do të bëjnë rregullimet e nevojshme ligjore.

h) Të gjitha inputet e siguruar nga TIKa në kuadrin e projektit do të përjashtohen nga të gjitha detyrimet, tarifat etj., dhe do të mundësohet tërheqja e këtyre inputeve nga zyrat doganore shqiptare sa më shpejt të jetë e mundur dhe të bëhet e vlefshme për Projektin.

i) Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit do të përballojë shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit të pjesëmarrësve të takimit të vlerësimit të përcaktuar në kuadrin e projektit.

Neni 5

Institucionet ekzekutive

Institucionet që do të ekzekutojnë këtë Projekt janë: TIKa, në emër të Palës Turke, dhe Ministria Shqiptare e Bujqësisë dhe Ushqimit, në emër të Palës Shqiptare.

Neni 6

Detyrimet e përbashkëta

a) Zbatuesit e Projektit do të jenë në gjendje të bëjnë amendamentet e duhura gjatë periudhës së Projektit me pëlqimin e Palës tjetër.

b) Në fund të 2-vjeçarit të parë do të bëhet një vlerësim dhe do të vendoset nëse do të vazhdojë Projekti apo jo, në përputhje të rezultateve të këtij vlerësimi.

c) Konsulenti i projektit, i emëruar nga TIKa, dhe koordinatori kombëtar shqiptar i Projektit do të përgatisin raporte progresive të detajuara çdo 6 muaj dhe do t'i prezantojnë ato autoriteteve shqiptare dhe TIKa-s.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Palët do të njoftojnë njera-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.

Protokolli do të hyjë në fuqi ditën e 30 marsit pas marrjes së njoftimit të fundit për plotësimin e këtyre procedurave.

Mosmarrëveshjet për çështjet e pasigluara në këtë Protokoll do të vendosen ndërmjet palëve.

Ky Protokoll është nënshkruar midis Kryeministrit të Turqisë, Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar dhe Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit të Shqipërisë në _____ 2001 në dy kopje në turqisht, shqip dhe anglisht të cilat janë të barasvlefshme.

Në rast mosmarrëveshjeje referohuni kopjes në anglisht.

Republika e Shqipërisë
Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit

Agron Duka

Republika e Turqisë
President i Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar
Dr.Oner Kabasakal

L I G J

Nr. 8879, datë 15.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT TEKNIK E FINANCIAR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e bashkëpunimit teknik e financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3310, datë 25.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE

PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK E FINANCIAR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Bazuar në lidhjet miqësore midis dy vendeve,
Me dëshirën e forcimit të mëtejshëm të këtyre lidhjeve dhe zhvillimit të një bashkëpunimi të frutshëm teknik e financiar,

Duke pasur parasysh se zhvillimi i këtij bashkëpunimi teknik dhe financiar do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve sociale dhe në nxitjen e reformave politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri,

Kanë rënë dakort si më poshtë:

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë kanë rënë dakord të nxisin bashkëpunimin ekonomik e social ndërmjet dy vendeve. Programi i bashkëpunimit do të koordinohet nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për Palën Shqiptare dhe nga Administrata Nërkombëtare Turke për Bashkëpunim (TICA) nën Këshillin e Ministrave për Palën Turke.

Qeveria e Republikës Turke, nëpërmjet TICA do të sigurojë asistencë teknike dhe trainim me projekte konkrete, duke përfshirë edhe përgatitjen e studimeve të fizibilitetit për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, duke bashkëpunuar me institucionet shtetërore dhe private nën koordinimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë. Secila Palë do të caktojë ekspertët që do të identifikojnë dhe përgatisin projektet në fushat e listuara më poshtë. Fushat që do të përfshihen, të cilat mund të mos jenë të vetmet, do të jenë:

1. energjia;
2. infrastruktura (transport dhe telekomunikacion, etj.);
3. privatizim, programe rehabilitimi për kalimin në ekonominë e tregut;
4. sistemi financiar;
5. bujqësi, blegtori, ujitje, peshkim;
6. rehabilitimi i industrisë;
7. ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
8. administratat lokale;
9. turizmi;
10. shëndetësia;
11. mjedisi;
12. arsimi, bashkëpunimi kulturor dhe shkencor;
13. vlerësimi i projekteve dhe blerjeve;
14. marrëdhëniet dhe organizatat ndërkombëtare (Banka Botërore, Agjensitë e Kombeve të Bashkuara, BERZH, OBT etj.);
15. marketingu dhe Tregtia e Jashtme.

Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Turqisë nëpërmjet TICA:

- a) të hapë në Tiranë Zyrën e Koordinimit të Programit dhe të sigurojë pajisjen e saj me

kompjuter dhe pajisje të tjera zyre;

b) të zgjedhë, të marrë dhe të paguajë personelin e nevojshëm për ZKP, përfshirë dhe stafin lokal;

c) të sigurojë mjetet e transportit për ZKP-në nëpërmjet blerjes ose qeramarrjes;

d) të paguajë pagat dhe udhëtimet ndërkombëtare për ekspertët turq;

e) të mbështesë financiarisht mbulimin e shpenzimeve të studimit të fizibilitetit;

f) të bëjë ndarjen e shpenzimeve të projekteve të asistencës teknike dhe të programeve të trajnimit;

g) të sigurojë konsulencë të nivelit të lartë, pa shpenzime, për koordinimin e ndihmës;

h) të lehtësojë fluksin e informacionit për të ndihmuar krijimin e programeve të informimit;

i) të sigurojë shërbimin mjekësor për specialistët shqiptarë, në bazë të legjislacionit turk dhe në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Turqi-Shqipëri në fushën e shëndetësisë, të firmosur më 6 prill 1989;

j) të paguajë qiranë e zyrës, si dhe shpenzimet për energji elektrike, ujë, ngrohje, gaz, etj.

Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë:

a) të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga specialistët shqiptaro-turq gjatë identifikimit të projektit, hartimit dhe implementimit;

b) të mbulojë shpenzimet e specialistëve shqiptarë;

c) të vërë në dispozicion një zyrë të përshtatshme për ZKP-në;

d) të furnizojë ZKP-në me energji elektrike, ujë, pajisje për ngrohje dhe gaz;

e) të lehtësojë procedurat e regjistrimit të ZKP-së;

f) të sigurojë përfaqësuesit e TICA-s ZKP-së, me të njëjtin status, si dhe përfaqësuesit e organizatave të tjera për kohëzgjatjen e shërbimit të tyre në Shqipëri;

g) shërbimi shëndetësor për ekspertët e TICA-s do të sigurohet në bazë të legjislacionit Shqiptar në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Turqi-Shqipëri në fushën e shëndetësisë, e firmosur më 6 prill 1998;

h) përjashtimin nga taksat doganore dhe TVSH-në e të gjithë materialeve që do të sillen për Shqipërinë nga TICA në kuadrin e ndihmës;

Projektet do të realizohen brenda kuadrit të kësaj Marrëveshje dhe do të implementohen nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta, duke përfshirë agjensi koordinimi dhe zbatim të të dy vendeve.

Progresi i arritur në kuadrin të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi do të vlerësohet periodikisht çdo vit përmes mbledhjeve të ndryshme të vlerësimit. Në këto mbledhje, që do të zhvillohen në Turqi dhe Shqipëri në mënyrë alternative, do të marrin pjesë koordinatorët turq dhe shqiptarë si dhe përfaqësues të projekteve që janë miratuar ose për të cilët është rënë dakort nga koordinatorët e të dyja palëve.

Marrëveshja është nënshkruar më 12.10.2001 në gjuhët shqip, turqisht dhe anglisht, secila në dy kopje me vlefshmëri të njëjtë.

Marrëveshja do të hyjë pas marrjes së njoftimit të fundit nga Palët për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore përkatëse.

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje është 5 (pesë vjet).

Koha e vlefshmërisë së Marrëveshjes do të zgjatet për pesë vjet të tjerë, në qoftë se asnjëra prej Palëve nuk do të njoftojë Palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për të ndryshuar ose për të anuluar marrëveshjen 3 muaj para përfundimit të tij.

Në rast kontradikte ndërmjet teksteve në gjuhën turke, shqipe dhe angleze, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Ermelinda Meksi
Ministre e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë

Për Qeverinë e Republikës së Turqisë

Prof.Dr.Abdulhaluk Mehmet Çay
Ministër Shteti

L I G J
Nr. 8880, datë 15.4.2002

PËR TË DREJTAT E SELEKSIONERIT TË BIMËVE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të personave që seleksionojnë, zbulojnë dhe zhvillojnë varietete të reja bimore.

Neni 2

Subjekte të zbatimit të ligjit

Kushtet e këtij ligji janë të zbatueshme për personat juridikë dhe fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj dhe për personat juridikë dhe fizikë, që janë shtetas:

- a) të palëve kontraktuese ose të shteteve që janë palë në traktatet dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të bimëve, në të cilat është palë edhe Republika e Shqipërisë;
- b) të shteteve që zbatojnë parimin e reciprocitetit.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji:

1. “Seleksioner” nënkupton personin fizik ose juridik, si dhe çdo punëmarrës që ka seleksionuar, zbuluar dhe zhvilluar një varietet të ri bimor.

2. “E drejta e seleksionerit” nënkupton të drejtën që i jep ky ligj seleksionerit për varietetin e ri, të zbuluar, të krijuar e të zhvilluar prej tij, si dhe të drejtat e pasuesit në titull.

3. “Varietet” nënkupton një grup bimor, brenda një ndarjeje të vetme botanike, të nivelit më të ulët të klasifikimit, që jepet kur përmbushen kushtet përkatëse për dhënien e së drejtës të seleksionerit, dhe mund të jetë:

a) shprehja e karakteristikave që janë rezultat i një gjenotipi të dhënë ose kombinim gjenotipesh;

b) i dallueshëm nga çdo grupim tjetër bimësh, qoftë edhe nga shprehja të paktën e njërit prej tipareve të lartpërmendura;

si një njësi e tërë, e cila nuk ndryshon gjatë shumëzimit.

4. “ESHFF” është Enti Shetëror i Farërave dhe i Fidanëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. “KSHAV” është Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve, i cili funksionon pranë ESHFF-së dhe që shqyrton, kualifikon ose jo varietetet e reja, të cilat shënohen në regjistrin e së drejtës të seleksionerit.

6. “Bord apelimi” është organi që ka për detyrë shqyrtimin e ankesës së aplikantit për vendimet e KSHAV-it për të drejtën e seleksionerit.

7. “Patentë” nënkupton dokumentin ligjor që vërteton të drejtën e seleksionerit dhe emërtimin e varietetit.

8. “Palë kontraktuese” nënkupton një shtet (tjetër nga Republika e Shqipërisë) ose një organizatë ndërqeveritare që është palë në Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Varieteteve Bimore.

9. “Zotërues ose pronar” nënkupton personin, të cilit i është dhënë e drejta e seleksionerit, sipas dispozitave të këtij ligji.

10. “Aplikant” është personi që ka dorëzuar një aplikim pranë organit përgjegjës për dhënien e së drejtës të seleksionerit.

11. “Pasues në titull” nënkupton trashëgimtarin e së drejtës të seleksionerit.

12. “Licencë e detyrueshme” nënkupton licencën e dhënë në mbështetje të këtij ligji.

13. “UPOV” është Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja.

14. “Mutant” nënkupton një bimë të re të përftuar nga një varietet i njohur më parë, si rezultat i ndryshimeve thelbësore të ndodhura në rrugë natyrore ose të nxitura artificialisht.

15. “Somaklonal” janë klone të rrjedhura nga zhvillimi i qelizave somatike ose vegjetative.

16. “Regjistri i aplikimit” është regjistri që mbahet nga ESHFF-ja për të gjithë personat që aplikojnë për të fituar të drejtën e seleksionerit të bimëve. Aplikimet e këtij regjistri botohen periodikisht.

17. “Regjistri i së drejtës të seleksionerit” është regjistri ku regjistrohen të gjithë personat fizikë dhe juridikë që kanë fituar të drejtën e seleksionerit. Edhe ky regjister mbahet nga ESHFF-ja. Të dhënat e këtij regjistri botohen periodikisht.

18. “Autorizim kontraktues” nënkupton çdo kontratë, me anë të së cilës njëra palë (autorizuesi) i jep palës tjetër (të autorizuarit) miratimin e vet për të realizuar në Republikën e Shqipërisë ndonjërin nga aktet e referuara në nenin 20 për një varietet bimor, subjekt i një aplikimi për dhënien e së drejtës të seleksionerit.

19. “Material” nënkupton:

a) materialin për shtimin e çdo varieteti (farë, fidan, copë, zhardhok, rizomë dhe kalem);
materialin e vjelë që përfshin bimë të plota dhe pjesë të bimëve.

KREU II

KUSHTET PËR DHËNIEN E SË DREJTËS TË SELEKSIONERIT

Neni 4

KUSHTET E NJOHJES

1. E drejta e seleksionerit jepet kur varieteti është i ri, i dallueshëm, uniform, i qëndrueshëm dhe subjekt i një emërtimi të dhënë sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.

2. Dhënia e së drejtës të seleksionerit nuk mund të jetë subjekt i ndonjë kushti tjetër, përveç kushteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 5

VARIETETI I RI

1. Varieteti është i ri nëse në datën e dorëzimit të aplikimit, materiali i shumëzuar ose materiali i vjelë i varietetit nuk është shitur, ofruar për shitje ose nuk u është përcjellë të tjerëve nga seleksioneri, me miratimin e vet ose nga pasuesi në titull, për qëllime të përdorimit të varietetit:

a) në territorin e Republikës së Shqipërisë për më shumë se një vit;

b) në një territor tjetër nga ai i Republikës së Shqipërisë për më shumë se 4 vjet ose, në rastin e pemëve dhe të hardhisë, për më shumë se 6 vjet.

2. Të qenit i ri nuk humbet si rezultat i ndonjë shitjeje ose transferimi tek të tjerët:

a) kur përbën pjesë të një marrëveshjeje për transferimin e të drejtave të varietetit;

b) kur përbën pjesë të një marrëveshjeje, sipas së cilës një person shumëzoi materialin e shtimit të varietetit në fjalë në emër të seleksionerit ose pasuesit në titull, duke siguruar se pronësia e materialit të shumëzuar i kthehet seleksionerit ose trashëgimtarit të tij të titullit dhe materiali i

shumëzuar nuk është përdorur për krijimin e një varieteti tjetër;

c) kur përfshin materialin e vjelë si një nënprodukt ose prodhim shtesë të varietetit ose të veprimtarive të referuara në shkronjën b të këtij neni, duke u siguruar se materiali i lartpërmendur është për qëllime konsumi.

Neni 6 VARIETETI I DALLUESHËM

1. Varieteti është i dallueshëm nëse ai është qartësisht i ndryshëm nga çdo varietet tjetër, i cili njihet në kohën e plotësimit të aplikimit.

2. Të dhënat e tjera që përdoren për të vlerësuar dallueshmërinë e një varieteti janë:

a) varieteti të jetë në përdorim;

b) varieteti të jetë i regjistruar në regjistrin e varieteteve, që mbahet nga ESHFF-ja ose në regjistra të shteteve të tjera anëtare të UPOV-it.

Neni 7 Varieteti uniform

Varieteti është uniform nëse ai nuk ndryshon gjatë shumëzimit të tij për tipare të veçanta, dhe ai është uniform në tipare dhe karakteristika kryesore.

Neni 8 Varieteti i qëndrueshëm

Varieteti është i qëndrueshëm kur tiparet kryesore të tij mbeten të pandryshuara pas shumëzimit të përsëritur ose dhe të një cikli të vetëm.

KREU III APLIKIMI PËR TË DREJTËN E SELEKSIONERIT

Neni 9 Parimet bazë

1. E drejta për aplikim për të fituar të drejtën e seleksionerit i njihet seleksionerit dhe pasuesit në titull. Aplikimi nga pasuesi në titull shoqërohet me dokumente që vërtetojnë qënien si të tillë.

2. Kur dy ose më shumë persona kanë seleksionuar, zbuluar dhe zhvilluar bashkërisht një varietet, titulli i seleksionerit do t'u kalojë në bashkëpronësi, nëse ndërmjet tyre nuk ka një marrëveshje me shkrim, që vërteton të kundërtën.

3. Kur varieteti është seleksionuar, zbuluar ose zhvilluar, sipas një kontrate komisioni ose kontrate pune, jashtë Republikës së Shqipërisë, e drejta për të plotësuar aplikimin për të drejtën e seleksionerit përcaktohet nga kontrata komisionuese ose marrëdhënia e punës, në kontekstin e të cilave u seleksionua, u zbulua dhe u zhvillua varieteti, në përputhje me kontratën ndërmjet palëve.

4. Kur varieteti është seleksionuar, zbuluar ose zhvilluar në ekzekutim të një kontrate komisioni ose kontrate pune, brenda Republikës së Shqipërisë, e drejta për të plotësuar aplikimin për të drejtën e seleksionerit do t'i përkasë, në mungesë të klauzolave kontraktuese të kontratës, personit që ka komisionuar punën ose punëdhënësit.

Neni 10 Përmbajtja e aplikimit

1. Çdo person që dëshiron të fitojë të drejtën e seleksionerit dhe të mbrojë një varietet plotëson një aplikim pranë ESHFF-së kundrejt një pagese.

2. Përmbajtja e hollësishme e aplikimit, dokumentet që i bashkëlidhen dhe pagesa e aplikimit parashikohen në rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Personat fizikë a juridikë të huaj mund të plotësojnë aplikime për të drejtën e seleksionerit

në zbatim të këtij ligji dhe të mbrojnë të drejtat e tyre me përfaqësues vendas ose të huaj, banues në Shqipëri, të pajisur me prokurë.

Neni 11 **Përparësitë**

1. Aplikanti gëzon të drejtën e përparësisë për një varietet në rastet kur ka një aplikim më të hershëm për të njëjtin varietet, të plotësuar prej vetë atij ose prej paraardhësit të tij në titull, me palën kontraktuese.

2. Kur aplikimi i mbushur për ESHFF-në paraprihet nga disa aplikime të tilla, përparësia mund të mbështetet vetëm mbi aplikimin më të hershëm.

E drejta e përparësisë do të kërkohej shprehimisht në aplikimin e mbushur për ESHFF-në. Ajo mund të kërkohej vetëm brenda një periudhe 12-mujore nga data e plotësimit të aplikimit më të hershëm.

3. Aplikanti paraqet në ESHFF një kopje të aplikimit të parë, brenda 3 muajve nga data e plotësimit, sipas pikës 3 të nenit 12.

ESHFF-ja ka të drejtë të rishohë aplikimin e parë brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës.

4. Efekti i përparësisë duhet të jetë i tillë që kur zbatohen kushtet e mbrojtjes për varietetin, të merret për bazë data e plotësimit të aplikimit të parë.

Aplikanti ka të drejtë të kërkojë që shqyrtimi i varietetit të shtyhet deri në 2 vjet nga data e skadimit të periudhës parësore, 3 vjet nga data e plotësimit të aplikimit të parë. Kur aplikimi i parë është hedhur poshtë ose është tërhequr, ESHFF-ja ka të drejtë të fillojë shqyrtimin e varietetit para datës së përcaktuar nga aplikanti. Në një rast të tillë, i jepet e drejta aplikantit që, brenda një periudhe të përshtatshme, të japë të dhëna të tilla, siç janë dokumentet ose materialin e kërkuar për të shqyrtuar varietetin.

KREU IV SHQYRTIMI I APLIKIMIT

Neni 12 **Kërkesat formale të shqyrtimit**

1. ESHFF-ja shqyrton aplikimin për përmbushjen e kërkesave formale.

2. Kur aplikimi nuk është i plotë, ESHFF-ja i kërkon aplikantit ta plotësojë dhe ta korrigjojë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Çdo aplikim që nuk korrigjohet brenda kësaj periudhe, vlerësohet sikur të mos ishte paraqitur.

3. Çdo aplikim, që është i plotë dhe i rregullt në përputhje me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji, regjistrohët në regjistrin e aplikimeve.

Neni 13 **Shqyrtimi paraprak i aplikimit**

1. ESHFF-ja shqyrton aplikimin për të verifikuar në bazë të të dhënave nëse varieteti është i ri dhe nëse aplikantit do t'i jepet e drejta e aplikimit, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji.

2. Kur aplikimi nuk i plotëson kërkesat e neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, ai hidhet poshtë.

Neni 14 **Shqyrtimi teknik i varietetit**

1. Varieteti i nënshtrohet shqyrtimit teknik, me qëllim që të përcaktohet nëse varieteti është i dallueshëm, uniform, i qëndrueshëm dhe mbi bazën e këtyre të bëhet përshkrimi zyrtar i varietetit, duke e shoqëruar me vlerësim agrobotanik.

2. Shqyrtimi teknik bëhet nga KSHAV-i dhe ka për objekt:

a) rezultatet e provave fushore dhe të provave të tjera të nevojshme të bëra nga ESHFF-ja ;

b) rezultatet e provave kultivuese dhe të provave të tjera të nevojshme të bëra nga ESHFF-ja ose nga ndonjë institucion tjetër, brenda ose jashtë Shqipërisë ;

c) pagesën e tarifave të parashikuara me rregullore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, në zbatim të këtij ligji.

3. Kushtet praktike të shqyrtimit përcaktohen me rregullore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 15

Dhënia e së drejtës të seleksionerit ose mosdhënia e saj

1. Kur si rezultat i shqyrtimeve paraprake dhe teknike vlerësohet se varieteti përmbush kërkesat e nenit 4 të këtij ligji dhe aplikanti plotëson kërkesat e tjera, të përcaktuara në këtë ligj, KSHAV-i jep të drejtën e seleksionerit dhe patentën e varietetit, të cilat shpallen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit brenda 30 ditëve nga dhënia e kësaj të drejte.

2. Dhënia e së drejtës të seleksionerit dhe përshkrimi i varietetit ose rrëzimi i aplikimit regjistrohen përkatësisht në regjistrin e aplikimit dhe në regjistrin e së drejtës të seleksionerit.

3. Modeli i patentës, i regjistrit të së drejtës të seleksionerit, përmbajtja e tyre dhe pagesa përcaktohen me rregullore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 16

E drejta e ankimit

1. Çdo vendim i marrë nga KSHAV-i i bëhet i ditur palës aplikuese brenda 5 ditëve.

2. Palës aplikuese duhet t'i jepet një mundësi për të parashtruar komentet e veta, me gojë ose me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Kundër vendimit të KSHAV-it bëhet ankim në bordin e apelimit. Krijimi, funksionimi dhe përbërja e bordit të apelimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

4. Kundër vendimit të bordit të apelimit bëhet ankim në gjykatë.

Neni 17

Shqyrtimi i vërejtjeve

1. Mosdhënia e së drejtës të seleksionerit i njoftohet aplikantit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit. Aplikanti, brenda një periudhe prej 3 muajsh, shpreh me shkrim vërejtjet për mosdhënien e së drejtës, duke theksuar nëse ai synon ta mbajë ose ta tërheqë aplikimin. Periudha mund të zgjatet me kërkesë të aplikantit.

2. Kur aplikanti nuk përgjigjet brenda periudhës së përcaktuar, aplikimi vlerësohet i tërhequr. Kur aplikanti kërkon ta mbajë aplikimin, përgjigjja e tij i bëhet e ditur KSHAV-it brenda 30 ditëve.

3. Aplikantit që ankohet për mosdhënien e së drejtës nga KSHAV-i, gjatë shqyrtimit teknik, i kërkohet të paraqesë të dhëna dhe dokumentacion plotësues, në mbështetje të ankimit të tij, ose material bimor, nëse është e nevojshme për shqyrtim teknik.

Neni 18

Ruajtja e dosjeve

1. ESHFF-ja mban një regjistër të aplikimeve dhe një regjistër për të drejtën e seleksionerit, të aplikantëve që e kanë fituar këtë të drejtë. Regjistrat janë të hapura për publikun.

2. Çdo person ka të drejtë të njihet me:

dokumentet që kanë lidhje me aplikimet;

dokumentet që kanë lidhje me të drejtën e seleksionerit;

c) të dhëna për provat e testimit dhe provat e tjera të nevojshme, të kryera sipas nenit 14.

3. Në rastin e varieteteve, prodhimi i të cilave kërkon përdorim të përsëritur të varieteteve të

tjera (komponentëve prindërorë), aplikanti kërkon që dokumentet dhe provat që kanë lidhje me komponentët, t'i mbahen të fshehta inspektimit.

4. ESHFF-ja arkivon dokumentet origjinale ose kopjet e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Botimet

1. Kërkesat për aplikim, në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, botohen në buletin e ESHFF-së.

2. ESHFF-ja boton në mënyrë periodike të dhënat që kanë lidhje me mbrojtjen e varieteteve bimore në buletin e ESHFF-së dhe konkretisht:

aplikimet për dhënien e së drejtës të seleksionerit;

aplikimet për emërtimet e varieteteve;

regjistrimet e emrave të rinj për varietetet e mbrojtura;

ç) tërheqjet e aplikimeve për dhënien e së drejtës të seleksionerit;

d) rrëzimin e kërkesës për aplikim për dhënien e së drejtës të seleksionerit;

dh) dhëniet e së drejtës të seleksionerit;

e) ndryshimet në të dhënat për aplikantët, trashëgimtarët dhe përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë;

ë) mbarimin e afatit të vlefshmërisë të së drejtës të seleksionerit;

f) licencat;

g) njoftimet zyrtare.

KREU V

TË DREJTAT E ZOTËRUESIT

Neni 20

Fusha e shtrirjes së të drejtës së zotëruesit

1. E drejta e zotëruesit për materialin shumëzues të varietetit të mbrojtur shtrihet në fushat e mëposhtme:

prodhimi ose riprodhimi (shumëzimi);

përpunimi për qëllime shumëzimi;

ofrimi për shitje;

ç) shitja ose çdo lloj marketimi tjetër;

eksportimi;

dh) importimi;

e) ruajtja ose magazinimi për secilin nga qëllimet e lartpërmendura.

2. Objekte të neneve 21 dhe 22 të këtij ligji janë veprimet që u referohen shkronjave a deri në dh të pikës 1 të këtij neni për materialin e vjelë, i cili përfshin pjesë të bimëve të marra përmes përdorimit të paautorizuar të materialit shumëzues të varietetit të mbrojtur, për të cilin kërkohet autorizimi i zotëruesit.

3. Zotëruesi mund të autorizojë shfrytëzimin e varietetit të mbrojtur për qëllimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, që janë subjekt i kushteve dhe i kufizimeve.

Neni 21

Përfshirjet për të drejtën e seleksionerit

E drejta e seleksionerit nuk shtrihet për:

veprime të kryera për qëllime jotregtare;

veprime të kryera për qëllime eksperimentale.

c) veprime të fermerëve që, për nevojat e veta, përdorin farëra të prodhuara në ngastrat e tyre.

Neni 22

Fushat ku nuk shtrihen të drejtat e seleksionerit

E drejta e seleksionerit nuk shtrihet në veprimet që kanë të bëjnë me material të varietetit të mbrojtur ose të përftuar prej tij, që janë shitur prej zotëruesit ose me autorizimin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë në rastet:

- kur nuk kemi të bëjmë me shtimin e mëtejshëm të varietetit në fjalë;
- b) kur nuk kemi të bëjmë me eksportin e materialeve shumëzuese të varietetit.

Neni 23

Kohëzgjatja e së drejtës të seleksionerit

E drejta e seleksionerit të bimëve të arave zgjat 20 vjet, ndërsa për bimët drufrutore, shkurret dhe drurët zbukurues zgjat 25 vjet. Të drejtat e seleksionerit dhe të zotëruesit për varietetin fillojnë që në momentin e aplikimit.

Neni 24

Licencimet e detyrueshme

1. Çdo person, me anë të një aplikimi, mund t'i kërkojë ESHFF-së dhënien e një licence të detyrueshme për të drejtën e seleksionerit, e cila jepet vetëm kur kjo e drejtë ndikon në mbrojtjen e interesave publikë.

2. Licenca e detyrueshme jepet kur aplikanti është i aftë të shfrytëzojë të drejtën e seleksionerit në mënyrë të përgjegjshme dhe të frytshme.

3. Procedurat dhe kushtet e dhënies së licencës të detyrueshme përcaktohen me rregullore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

KREU VI

EMËRTIMET E VARIETETEVE

Neni 25

Emërtimi

1. Emërtimi i një varieteti të mbrojtur përcaktohet nga shenjat kryesore dalluese të tij.

2. Emërtimi mund të jetë një fjalë, një kombinim fjalësh, kombinim fjalësh dhe figurash ose kombinim shkronjash e figurash, mjafton që këto shenja të lejojnë identifikimin e varietetit.

3. Kur në një kontratë ndërmjet palëve është propozuar ose regjistruar për t'u përdorur një emërtim për një varietet, atëherë do të përdoret vetëm ky emërtim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Ndalohet përdorimi i një emërtimi të njëjtë ose të ngjashëm, por që sjell ngatërresa ndërmjet këtij varieteti dhe një varieteti tjetër të të njëjtit lloj ose të një lloji të afërt me të në territorin e Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa shfrytëzohet ky varietet. Ndalimi i lartpërmendur zbatohet edhe për emërtimet e regjistruara në kontratat ndërmjet palëve.

5. Çdo person që ofron për shitje, shet ose marketon materialin shumëzues të një varieteti të mbrojtur, detyrohet të përdorë emërtimin e varietetit.

6. Detyrimi për të përdorur emërtimin nuk mbaron me të drejtën e seleksionerit, për sa kohë që ai është në prodhim a tregtim.

7. Kur një varietet ofrohet për shitje ose marketohet, përdorimi i emërtimit të varietetit të regjistruar së bashku me një markë tregtare, emër tregtar ose dhe tregues të tjerë të ngjashëm lejohet, me kusht që emërtimi të dallohet me lehtësi.

Neni 26

Procedura e regjistrimit

1. Emërtimi i propozuar për një varietet paraqitet së bashku me aplikimin për mbrojtje.

Aplikanti ndjek procedurën për regjistrimin e emërimit të varietetit, pasi paguan tarifën e parashikuar dhe paraqet një emër të përkohshëm për të në aplikim. Në këtë rast aplikanti propozon një emërtim të ri për varietetin brenda 30 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë të adresuar për ESHFF-në. Nëse aplikanti nuk paraqet një propozim brenda periudhës së përshkruar, aplikimi rrëzohet.

2. Nëse plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 25 të këtij ligji, emërtimi i varietetit botohet në buletin e ESHFF-së.

3. Çdo person i interesuar mund të bëjë vërejtje brenda 3 muajve pas botimit për regjistrimin e emërimit, për një nga arsyet për mosdhënien e së drejtës të seleksionerit, sipas nenit 25 të këtij ligji.

4. Kundërshtimet dhe vërejtjet i komunikohen me shkrim aplikantit brenda 30 ditëve.

5. Aplikanti, në bazë të kundërshtimeve dhe vërejtjeve, mund të paraqesë një propozim të ri.

Kur emërtimi i propozuar nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 25 të këtij ligji, ESHFF-ja i kërkon aplikantit të paraqesë një propozim të ri brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim. Mosparaqitja e një propozimi të ri brenda kësaj periudhe pasohet me rrëzimin e aplikimit.

6. Propozimi i ri është subjekt rishqyrtimi.

Kur propozimi i ri nuk është në përputhje me kërkesat e këtij neni, ESHFF-ja i dërgon njoftim aplikantit për një emërtim që të jetë në përputhje me kushtet e lartpërmendura. Mospropozimi i një emërtimi të ri sjell rrëzimin e aplikimit.

7. Kur kundërshtimet ose vërejtjet nuk merren parasysh, çdo vendim i KSHAV-it shoqërohet me një deklaratë, ku shpjegohen arsyet e këtij vendimi. Vendimi u njoftohet palëve. Mospranimi i një emërtimi të propozuar, gjithashtu, shoqërohet me vendim.

8. Emërtimi regjistrohet në të njëjtën datë kur jepet e drejta e seleksionerit.

KREU VII MBAJTJA E SË DREJTËS TË SELEKSIONERIT

Neni 27 **Pagesa vjetore**

Mbajtësi i titullit të varietetit paguan deri më 31 janar të çdo viti pranë ESHFF-së një pagesë vjetore për tërë periudhën e kohëzgjatjes së të drejtës së seleksionerit. Masa e pagesës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28 **Mirëmbajtja e varietetit**

1. Mbajtësi i titullit duhet të mirëmbajë varietetin e mbrojtur ose përbërësit e tij prindërorë për tërë kohëzgjatjen e së drejtës të seleksionerit.

2. Me kërkesën e ESHFF-së, mbajtësi i titullit ose një autoritet i caktuar prej tij, brenda periudhës së përshkruar, duhet të japë të dhëna të shoqëruara me dokumente ose materiale të gjykuara të nevojshme për verifikimin e mirëmbajtjes së varietetit.

3. Kushtet e mirëmbajtjes së varietetit përcaktohen me rregullore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 29 **Verifikimi i mirëmbajtjes së varietetit**

ESHFF-ja, gjatë periudhës së mbrojtjes, verifikon nëse varieteti dhe përbërësit e tij prindërorë mirëmbahen.

KREU VIII
MBARIMI I SË DREJTËS TË SELEKSIONERIT

Neni 30
Pavlefshmëria

1. KSHAV-i deklaron pavlefshmërinë dhe heq të drejtën e seleksionerit kur ajo është e miratuar, në rast se nga verifikimi rezulton se varieteti nuk është i ri, uniform, i dallueshëm, i qëndrueshëm dhe kur ajo i është dhënë një personi që nuk i takon e drejta e pasuesit në titull.

2. Kur e drejta e seleksionerit është deklaruar e pavlefshme dhe është hequr, sepse është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, prezumohet si e padhënë.

3. Çdo person mund të paraqesë pranë KSHAV-it një kërkesë për anulimin e së drejtës të seleksionerit; KSHAV-i ka të drejtë të veprojë edhe me nismën e vet.

Neni 31
Anulimi i së drejtës të seleksionerit

1. KSHAV-i heq të drejtën e seleksionerit kur mbajtësi i titullit ka dështuar në mirëmbajtjen e varietetit dhe varieteti nuk është më uniform dhe i qëndrueshëm.

2. E drejta e seleksionerit hiqet kur:

a) mbajtësi i titullit nuk përmbush kërkesën e bërë nga ESHFF-ja për verifikimin e mirëmbajtjes së varietetit;

b) KSHAV-i propozon heqjen e emërimit të varietetit kur seleksioneri nuk propozon një emër të përshtatshëm brenda periudhës së parashikuar.

3. Mbajtësit të titullit i bëhen të ditura me një njoftim me shkrim arsyet pse KSHAV-i ka propozuar heqjen e së drejtës të seleksionerit, duke i lënë një afat kohor prej 30 ditësh, të cilësuar në njoftim, për të vepruar menjëherë në përputhje me vendimin.

4. Heqja e së drejtës të seleksionerit hyn në fuqi në datën e regjistrimit të saj në regjistrin e së drejtës të seleksionerit të bimëve.

KREU IX
PRONËSIA E PËRBASHKËT

Neni 32

Çdo kontratë ndërmjet palëve për aplikimin e përbashkët për të drejtën e seleksionerit bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët. Kontrata parashikon sanksione në rastet e shkeljes së saj dhe të shndërrimit të aplikimit në të pavlefshëm.

Neni 33

1. Në rastin kur janë disa aplikantë që kërkojnë të drejtën e seleksionerit, secilit prej tyre i njihet mundësia që pa marrëveshje me të tjerët të caktojë ose të transferojë me trashëgimi pjesën e vet të aplikimit. Gjithashtu, aplikantë të përbashkët mund të tërheqin aplikimin ose të përmbyllin kontrata me palët e treta vetëm sipas aplikimit të përbashkët.

2. Kur ka pronarë të përbashkët të së drejtës të seleksionerit, secili prej tyre gëzon të drejtën që, pa marrëveshje me të tjerët, të caktojë ose të transferojë me trashëgimi pjesën e vet të së drejtës të seleksionerit, ose të ndërmarrë procedura gjyqësore për shqyrtimin e një cenimi ndaj së drejtës të seleksionerit kundër çdo personi që shfrytëzon varietetin e mbrojtur në Republikën e Shqipërisë. Shfrytëzimi i varietetit të mbrojtur në Republikën e Shqipërisë nga njëri prej pronarëve të përbashkët nuk kërkon marrëveshjen me bashkëpronarët e tjerë, por bashkëpronarët kanë të drejtë të heqin dorë nga e drejta e seleksionerit të bimëve ose të lidhin kontrata me palët e treta, sipas të drejtës së përbashkët të seleksionerit të bimëve.

3. Përcaktimet e këtij neni janë të zbatueshme vetëm në mungesë të marrëveshjes për kundërshtimet ndërmjet aplikantëve ose pronarëve të përbashkët.

KREU X AUTORIZIMET KONTRAKTUESE DHE TË SË DREJTËS

Neni 34

1. Autorizimi kontraktues bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.
2. Autorizimi kontraktues i nënshkruar regjistrohet në regjistrin e së drejtës të seleksionerit pas pagesës së përcaktuar për licencim. I licencuari gëzon të drejtën të nisë një procedurë ligjore për autorizimin kontraktues vetëm nëse ajo është regjistruar në regjistrin e së drejtës të seleksionerit.

Neni 35

1. Në mungesë të një klauzole për kundërshtime për autorizimin kontraktues, autorizuesi mund të lejojë një palë të tretë të kryejë për varietetin e mbrojtur ndonjë nga veprimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji.
2. Nëse kontrata përcakton se autorizimi është një i vetëm dhe po të mos jetë parashikuar ndryshe, asnjë palë e tretë, madje dhe vetë licencuesi nuk ka të drejtë të kryejë cilindo nga veprimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji për varietetin e mbrojtur.

KREU XI KUNDËRVAJTJET

Neni 36

Sipas këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative:

- a) shkeljet e parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 20 të këtij ligji për kryerjen e veprimeve prej subjekteve të ndryshme nga zotëruesi, pa lejen e tij, për prodhimet që mbron patenta ;
- b) shkeljet e parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 20 të këtij ligji për kryerjen e veprimeve prej subjekteve të ndryshme nga aplikanti dhe pa lejen e tij, që lidhen me prodhimin që ka në mbrojtje të përkohshme, sipas nenit 23 të këtij ligji.

Neni 37

Pronari i së drejtës të seleksionerit dhe aplikanti për të drejtën e seleksionerit gëzojnë të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj çdo personi që shkel të drejtën e seleksionerit ose dhe mbrojtjen e përkohshme. Pronari i së drejtës të seleksionerit dhe aplikanti kanë të njëjtat të drejta ndaj çdo personi që kryen akte që mundësojnë një shkelje. Procedurat ankimore nuk mund të ndërmerren në qoftë se ka kaluar një periudhë prej 5 vjetësh nga data e kryerjes së shkeljes.

KREU XII MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 38

1. Shkeljet e parashikuara në shkronjat a dhe b të nenit 36 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 150 000 lekë, nga inspektorët e Inspektoriatit të Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.
2. Në rast përsëritjeje të këtyre shkeljeve, vendoset dyfishi i gjobës maksimale.
3. Procedurat e ekzekutimit të gjobës bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.
4. Gjohat e vjela kalojnë 60 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 40 për qind te zotëruesi i patentës.

KREU XIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të nenit 27 të këtij ligji dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për nenet 10, 14, 15, 16, 24 dhe 28.

Neni 40
Shfuqizimi

Neni 4 i ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 "Për materialin mbjellës bimor" shfuqizohet.

Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3311, datë 25.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 170, datë 25.4.2002

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË KUSHTEVE PËR DHËNIEN E LEJEVE
E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS , GAZIT E NËNPRODUKTEVE TË
TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 20 e 21 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me propozimin e Ministrisë të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Procedura e dhënies së lejeve të tregtimit

Shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre pajisen me lejen e tregtimit nga ministri që mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

a) Leje e llojit "A", që u jepet shoqërive për tregtimin e naftës e të nënprodukteve të saj, me përjashtim të nënprodukteve të përcaktuara për përdorim nga mjetet e flututimit ajror.

b) Leje e llojit "B", që u jepet shoqërive për tregtimin e gazit të lëngshëm.

c) Leje e llojit "C", që u jepet shoqërive për tregtimin e nënprodukteve të naftës për mjetet e fluturimit ajror.

Dhënia e lejeve të tregtimit bëhet në bazë të procedurave të mëposhtme:

1. Subjekti paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Hidrokarbureve kërkesën për marrjen e lejes së tregtimit, të pëcaktuar për kategorinë e produkteve, që do të tregtojë.

2. Dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesën janë:

a) vendimi i gjykatës për regjistrimin e personit juridik;

b) certifikata e regjistrimit në zyrën e tatimeve dhe dokumenti i NIPT-it;

c) vërtetimi i pronësisë ose kontrata e qerasë për depozitat që do të përdorë subjekti;

ç) projekti teknologjik i depove dhe i linjave, i miratuar nga organet e qeverisjes vendore të mbrojtjes nga zjarri dhe të mjedisit; Për lejet e llojit "A" kategoria IV/a, projekti teknik i magazinës së vajrave.

d) akti i kontrollit dhe leja e shfrytëzimit, të lëshuara nga zyra e urbanistikës;
dh) vërtetimi për kontrollin e objektit për respektimin e kushteve teknike, i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit, Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre.

e) certifikata e matjes së vëllimit të depove nga organet përkatëse të kalibrimit dhe metrologjisë, në njësitë e qeverisjes vendore; Përfshihen nga kjo kërkesë subjektet që kërkojnë të pajisen me leje të llojit "A", kategoria IV/a (vajra lubrifikante).

ë) vërtetimi i pronësisë ose kontrata e marrjes në përdorim e mjeteve të transportit për naftën, gazin dhe nënproduktet e saj.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve ushtron kontroll për vërtetësinë e të dhënave dhe të treguesve të paraqitur në dokumentacionin e subjektit kërkuar.

4. Kur nga vërtetimi i të dhënave dhe treguesve rezulton se janë plotësuar kushtet e kërkuara, ministri jep lejen e tregimit të veçantë, sipas kategorive përkatëse të produktit që do të tregohet.

5. Afati për ushtrimin e kontrollit dhe afati i dhënies së lejes nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës së subjektit në ministri.

6. Kur nga vërtetimi i të dhënave dhe treguesve rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuar, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit, i cili mund t'i riparaqesë pas plotësimit.

7. Kur, pas afatit prej 30 ditësh nga çasti i depozitimit të kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka të drejtë të ankohet në përpuhtje me procedurat administrative.

II. Procedura për dhënien e autorizimeve

Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombulave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.

1. Për marrjen e autorizimeve për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm ose vajrave lubrifikante dhe për stacionet e mbushjes së bombulave të gazit të lëngshëm, subjekti duhet të paraqesë, pranë organit që ka në varësi dhënien e autorizimit, këto dokumente:

a) vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik;

b) certifikatën e regjistrimit në zyrën e tatimeve;

c) projektin teknologjik të depove dhe linjave, të miratuar nga organet e qeverisjes vendore të mbrojtjes nga zjarri dhe të mjedisit;

ç) aktin e kontrollit dhe lejen e shfrytëzimit, të lëshuar nga zyra e urbanistikës;

d) vërtetimi për kontrollin e objektit për respektimin e kushteve teknike të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit, Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre;

dh) certifikatën e kalibrimit të rezervuarëve, të vendosur në stacion dhe të matjes së aparateve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe stacionet e mbushjes së bombulave të gazit të lëngshëm, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore.

2. Organet, që kanë përgjegjësi për dhënien e autorizimeve, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e subjektit kërkuar.

3. Kur pas vërtetimit, të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacion plotësojnë kushtet e kërkuara, organi përkatës jep autorizimin për ushtrimin e veprimtarisë në stacionin e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm. Afati për kontrollin e dokumentacionit dhe plotësimin e autorizimeve nuk mund të jetë më i madh se 15 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës në organin që ka detyrë dhënien e autorizimit.

4. Kur, pas vërtetimit, të dhënat dhe treguesit nuk plotësojnë kërkesat, dokumentet e paraqitura i kthehen subjektit dhe afati i mësipërm fillon me riparaqitjen e tyre.

5. Kur, pas afatit prej 15 ditësh nga çasti i paraqitjes së kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka të drejtë të ankohet sipas procedurave administrative.

6. Dhënia e autorizimeve për njësitë e shitjes së lëndës djegëse bëhet nga organet e qeverisjes vendore. Subjekti që kërkon të pajiset me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse, duhet të paraqesë këto dokumente:

a) Vërtetimin për pronësinë apo kontratën për marrjen në përdorim të mjedisit përkatës;

b) vërtetimin për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre;

c) certifikatën e kalibrimit të enëve dhe aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore.

7. Afati për vërtetimet e nevojshme dhe plotësimin e autorizimeve për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse nuk mund të jetë më i madh se 10 ditë nga data e mbërritjes së kërkesës.

8. Kur nga vërtetimet rezulton se nuk janë plotësuar kushtet e caktuara, dokumentet i kthehen subjektit dhe afati i mësipërm fillon me riparaqitjen e tyre.

9. Kur, pas afatit prej 10 ditësh nga çasti i paraqitjes së kërkesës, subjektit nuk i është kthyer përgjigje, ai ka të drejtë të ankohet sipas procedurave administrative.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundëjt pagesës nga subjekti kërkuar.

Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:

1. Për lejet e tregtimit të llojit "A" 500 000 lekë
2. Për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë
3. Për lejet e tregtimit të llojit "C" 200 000 lekë
4. Për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikantë dhe të stacioneve të mbushjes së bombulave të gazit të lëngshëm 100 000 lekë
5. Për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50 000 lekë.

Tarifat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.

Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e tarifave për pikat 1,2 dhe 3 të përdoren në masën 90 për qind nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet, për financimin e veprimtarisë së strukturave të kësaj ministrie, për investime, ndjekje dhe monitorim të tregut të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, kualifikimin profesional dhe për përpunimin e botimit e të dhënave për këtë treg.

Të ardhurat, që realizohen nga pagesat e tarifave për pikat 4 dhe 5, të përdoren, në bazë të vendimit nr. 424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

IV. Kushtet për pajisjen me leje tregtimi

1. Kapitali minimal i kërkuar është kapitali themeltar i shoqërisë anonime.

2. Kapaciteti më i vogël i depozitave të shoqërive, që kërkojnë të pajisen me leje tregtimi, sipas llojit të lejes, është:

- Për lejet e tregtimit të llojit "A", jo më pak se 300 m³ dhe kur kjo leje e tregtimit jepet për disa kategori produktesh, depozitat duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra, me një kapacitet të përbashkët jo më pak se 300 m³.

- Për lejet e tregtimit të llojit "A", kategoria IV/a, kapaciteti magazinues i mbuluar të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 50 m².

- Për lejet e tregtimit të llojit "B", impiantet e depozitimit të gazit të jenë me kapacitet të instaluar, jo më të vogël se 50 m³.

- Për lejet e tregtimit të llojit "C".

Kur leja jepet për produkte të kategorisë II/b, jo më pak se 50 m³.

Kur leja jepet për produkte të kategorisë III/c, jo më pak se 200 m³.

Bëjnë përjashtim nga kushti i plotësimit të kapacitetit më të vogël, sipas kësaj pike, shoqëritë anonime që kanë marrëdhënie kontraktore, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për depozitat e karburanteve në portin e Durrësit. Kushti i kapacitetit më të vogël i depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse dhe i kalibrimit të tyre, duhet të plotësohet brenda 18 muajve pas fillimit të zbatimit të masterplanit, në territorin e depozitave të karburanteve në portin e Durrësit.

3. Shoqëritë anonime, që kërkojnë të marrin lejen e tregtimit, duhet të kenë në pronësi ose në përdorim, në çastin e kërkesës për leje dhe gjatë gjithë kohës së veprimtarisë, një mjet transporti për naftë, gaz apo nënprodukte të tyre.

4. Depozitat e subjekteve, që kërkojnë të pajisen me leje të llojit "A", "B" dhe "C", (përjashtim bëjnë lejet e llojit "A", kategoria IV/a (vajra lubrifikante), duhet të jenë të kalibruara nga organet përkatëse të metrologjisë e të kalibrimit në njësitë e qeverisjes vendore.

5. Lejet e tregtimit duhet të përmbajnë:

- a) numrin e lejes dhe datën e lëshimit të saj;
- b) emrin dhe selinë e subjektit që merr lejen;
- c) llojin e lejes dhe kategorinë e produktit që do të tregtohet;
- ç) afatin e vlefshmërisë së lejes;

d) vendndodhjen e depozitave ose të magazinës;
dh) llojin dhe afatin e dokumentacionit, që duhet të dërgojnë në ministri.
6. Të dhënat e përcaktuara në shkronjat a, b, c, ç, d të pikës 7 të këtij vendimi janë të vlefshme dhe për autorizimet.

V. Hartimi i kushteve teknike

1. Kushtet teknike, që duhen respektuar në të gjitha pajisjet, impiantet, instalimet, stacionet, repartet dhe linjat teknologjike përcaktohen më urdhët të ministrit që mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

2. Kushtet teknike janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë në përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

3. Ministria që mbulon veprimtarinë hidrokarbure të botojë kushtet teknike.

VI. Heqja e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve

Në rast të moszbatimit të sanksionit të dhënë për shkeljet e përcaktuara në ligj, organi që jep sanksionin ka të drejtën e ndërprerjes deri në 30 ditë të veprimit të lejes së tregtimit ose të autorizimit përkatës, për ushtrimin e veprimtarisë.

Në rast të mosreagimit ndaj sanksionit për ndërprerje të lejes së tregtimit apo autorizimit, ose për përsëritje nga subjekti të shkeljeve të përcaktuar në ligj, organi përkatës ka të drejtën e heqjes së lejes së tregtimit apo autorizimit për ushtrimin e veprimtarisë.

VII. Vendimet nr. 129, datë 18.3. 1999; nr 576, datë 8.12.1999; nr. 4, datë 12.1.2000; nr. 719, datë 21.12.2000; si dhe nr. 681, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

VIII. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr.190, datë 9.5.2002

PËR PUBLIKIMIN PËR HERË TË DYTË TË DISA OBJEKTEVE DHE PJESËVE TË KAPITALIT SHETETËROR NË SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT, PËR TË CILAT KANË FILLUAR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7512, dtaë 10.8. 1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Publikimin për herë të dytë të objekteve të listës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat kanë filluar procedurat e privatizimit, sipas vendimit nr. 192, datë 20.3. 1998 të Këshillit të Ministrave, por që ende nuk janë zhvilluar ankandet.

2. Publikimin për herë të dytë të objekteve të listës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat kanë filluar procedurat e privatizimit, sipas vendimit nr. 283, datë 18.6.1999 të Këshillit të Ministrave, por që ende nuk janë zhvilluar ankandet.

3. Publikimin për herë të dytë të pjesëve të kapitalit shtetëror në shoqëritë me kapital të përbashkët, të listës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat kanë filluar procedurat e privatizimit, sipas vendimit nr. 230, datë 4.4.1998 të Këshillit të Ministrave, por që ende nuk janë zhvilluar ankandet.

4. Procedurat e kryera deri më sot nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit për objektet dhe pjesët e kapitalit shtetëror, në shoqëritë me kapital të përbashkët, të listave të mësipërme, anulohen.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

LISTA NR. 1
LISTA E OBJEKTEVE QË JANË NË PROCEDURËS KONFORM VKM NR. 192,
DATË 20.3.1998

Nr.	Emërtimi i objekteve
1	“Dush, gardërobë” të Uzinës PVC Vlorë
2	“Muzeu, qendra e zërit” të Uzinës PVC Vlorë
3	“Ndërtesa e peshores+peshore” të Min.G.Kuq Pogradec
4	“Ndërtesa e garazhdit” të Min G.Kuq Pogradec
5	“Spitali ushtarak i divizionit” të Rep. Usht. 3300 Burrel
6	“Trup roje tip i madh” të Rep. Usht. 3300 Burrel
7	“Dush, banjo, gardërobë tip “1” të Uzinës 12 Elbasan
8	“Optika” të DSHP Durrës
9	“Librari Maliq” të NLSH Tiranë
10	“Librari Orikum”, të NLSH Tiranë
11	“Librari Shengjin” të NLSH Tiranë
12	“Librari Shijak” të NLSH Tiranë
13	“Agjenci transporti Pogradec” të DSHR Korçë

LISTA NR.2
LISTA E OBJEKTEVE QË JANË NË PROCEDURËS KONFORM VKM NR. 283,
DATË 18.6.1999

(me rezervë)

Nr.	Emërtimi i objekteve
1	“Furrë stacionare” Rep. Usht, 5013 Gjeroven Berat
2	“Tharëse misri” N.B. Drino Gjirkastër

me zarfa të mbyllur

Nr.	Emërtimi i objekteve
1	“Retifike cilindrike” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
2	“Sharrë druri” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
3	“Torno druri” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
4	“Torno tos” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
5	“Torno SU” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
6	“Kompresor monotype” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
7	“Kompresor monotype” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
8	“Makinë për shtyp EKAP TD4” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
9	“Rrotativa” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
10	“Sharrë diskore” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
11	“Ratifikë plumbi” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
12	“Makinë gdhendje polimere” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
13	“Kalandër” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë

14	“Thikë dore” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
15	“Thikë treanëshe” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
16	“Agregati i revistave” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
17	“Makinë shtypi ramojon” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
18	“Makinë shtypi offset” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
19	“Kamion Benz” të Shtypshkronjës Mihal Duri Tiranë
20	“Magazinë” Nd/ja Ndërtimit Librazhd
21	“Banjo, WC” Nd/ja Pastrimit Berat

LISTA NR.3
LISTA E SHOQËRIVE PËR SHITJEN E PJESËVE TË KAPITALIT SHTETËROR
NË SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT KONFORM VKM NR.230,
DATË 4.4.1998 ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Nr.	Emërtimi i shoqërisë
1	“Scherer Moda Shkodër” sh.p.k. 45% e aksioneve

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 13. 5. 2002
Doli nga shtypi më 13. 5. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë

